

VENDIM
Nr. 94, datë 28.4.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SOLAR HORIZON” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1329/9 prot., datë 25.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Solar Horizon’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Solar Horizon” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1329 prot., datë 13.3.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61, datë 27.3.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE ka publikuar njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.3.2025 dhe 29.3.2025) dhe në faqen zyrtare të internetit. Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (deri më datë 8.4.2025), nuk janë paraqitur komente apo kundërshtime.

- ERE, me shkresën nr. 1329/4 prot., datë 2.3.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka kërkuar dokumentacionin e munguar.

- Po ashtu, me shkresën nr. 1329/5 prot., datë 2.4.2025, ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), duke i kërkuar që të paraqesë një qëndrim lidhur me zbatimin e afateve të ndërtimit/vënies në punë të centralit dhe vlefshmërinë e kontratës. Nga ana e MIE-s nuk është depozituar asnjë përgjigje.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1329/6 prot., datë 4.4.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues. Pas shqyrtimit, ERE ka kërkuar dokumentacion shtesë me *e-mail*-in nr. 1329/7 prot., datë 23.4.2025, dhe shoqëria ka depozituar dokumentacionin e plotësuar me *e-mail*-in e datës 25.4.2025, protokolluar me nr. 1329/8 prot.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezultoi se:

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën nr. 2427 rep., nr. 1572 kol., datë 28.4.2023, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse.

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSSH sh.a. nr. 11491/5 prot., datë 13.12.2024.

- Ka depozituar vendimin për VNM paraprak, lëshuar më 17.7.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik me kapacitet 2 mw, si dhe ka dokumentuar në ERE fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- Kontrata e nënshkruar me MIE parashikon një afat 49-vjeçar me të drejtë ripërsëritjeje. Sipas nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, dhe nenit 5 të Rregullores së licencimit, licenca për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike jepet për një afat deri në 30 vjet.

- Shoqëria ka depozituar një garanci 30-vjeçare për performancën e paneleve fotovoltaike, ndaj afati i licencës vlerësohet të jetë 30 vjet.

- Sipas dokumentacionit të depozituar dhe nenit 9 të kontratës së nënshkruar me MIE, shoqëria duhet të vendosë në operim centralin brenda muajit qershor 2025.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kësaj kontrate, vlerësohet që shoqërisë t'i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të vendimit në rast të ndonjë qëndrimi të ndryshëm nga MIE, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës.

- Aktualisht, shoqëria ka siguruar stafin teknik përmes kontraktorëve të jashtëm dhe ka deklaruar se, pas marrjes së licencës, do të përditësojë strukturën organizative me stafin teknik të brendshëm, sipas veprimtarisë së licencuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Solar Horizon” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, brenda datës 30.6.2025.

3. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe të përditësojë informacionin mbi strukturën organizative të saj, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të përmbushjes, apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Solar Horizon” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

